

1. TE DHENA TE PERGJITHSHME MBI SHOQERINE

Top Channel sh.a. ("Shoqeria") eshte nje kompani aksionere, e cila eshte krijuar ne vitin 2001 me vendim gjykatë Nr. 25561 date 29.03.2001. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregtare" dhe nga statuti i saj. Adresa e selise se shoqerise eshte Qendra Nderkombetare e Kultures, Tirane.

Aktiviteti kryesor i kesaj shoqerie eshte ne fushen e veprimtarise televizive kombetare qe perfshin prodhimin, transmetimin e programeve te informacionit te cdo lloji me ane te zerit dhe figures, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuar per publikun.

Veprimtaria radiotelevizive zhvillohet ne perputhje me ligjin nr. 7491, date 29.4.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me aktet nderkombetare te ratifikuara nga Republika e Shqiperise, me dispozitat e ligjit Nr. 8410, date 30.9.1998 PER RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK E PRIVAT NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE (ndryshuar me ligjin nr. 8655 date 31.07.2000, me ligjin nr. 8794 date 10.05.2001, me ligjin nr.9016 date 20.2.2003, me ligjin nr.9124 date 29.07.2003, me ligjin 9531 date 11.05.2006 dhe me ligjin nr. 9677, date 13.01.2007), me ligjin nr. 8288, date 18.2.1998 "Per Entin Rregullator te Telekomunikacioneve", me ligjin nr.7564, date 19.5.1992 "Per te drejten e autorit", ndryshuar me ligjin nr. 7923, date 19.4.1995, si dhe me dispozitat e tjera ligjore qe jane ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Pasqyrat financiare jane te konsoliduara duke perfshire Pasqyrat financiare Top Channel Tirane dhe Dega Kosove dhe Shkup (Maqedoni).

Perfaqesues Ligjor i shoqerise Top Channel sh.a eshte z.Enkelejdi Joti

Kompania ka 596 punonjes deri me 31 Dhjetor 2014 per zyren e Tiranes. (2013: 556)

2. POLITIKAT KONTABEL

2.1 Bazat e Pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te leshuara nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti per Interpretimet Nderkombetare te Raportimit Financiar ("KIRFN") te BSNK-se. Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazat e kostos historike. Pasqyrat financiare jane paraqitur ne monedhen vendase Leke.

2.2 Klima e biznesit ne Shqiperi

Kriza globale ekonomike dhe financiare ne vazhdim qe erdhi si rezultat i nje ulje te ndjeshme ne likuiditetin global e cila filloi ne mes te vitit 2007 ka çuar midis te tjerash ne nje nivel te ulët financimi ne tregjet e kapitalit, ne nivele te ulëta likuiditeti ne sektorin bankar dhe me gjerë, ne norma me te larta huamarrje ndërbankare dhe ne nje paqëndrueshmëri te lartë ne tregjet e kapitalit dhe te monedhave. Pasiguritë ne tregjet globale financiare kanë çuar ne falimentimin e shumë bankave dhe korporatave si dhe ne shtetëzimin e shumë bankave te tjera ne SHBA, Europën Perëndimore. Rusi etj. Shtrirja e madhe e ndikimit te kesaj krize globale ekonomike dhe financiare duket te jetë e vështirë për te parashikuar ose për tu mbrojtur.



2. POLITIKAT KONTABEL (vazhdim)

2.3 Klima e biznesit ne Shqiperi (vazhdim)

Drejtimi nuk është në gjendje të përcaktojë në mënyrë të besueshme efektet në pozicionin financiar të ardhshëm të Shoqërisë në rast të ndonjë përkeqësimit të mëtejshëm në mjedisin operacional të Shoqërisë si rezultat i krizës në vazhdim. Drejtimi i Shoqërisë beson se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbështetur ruajtjen dhe zhvillimin e biznesit të Shoqërisë në kushtet aktuale.

Ndikimi tek konsumatorët/huamarrësit:

Debitorët e shoqërisë mund të ndikohen në mënyrë të pafavorshme nga mjedisi financiar dhe ekonomik i cili do të ndikonte në aftësinë e tyre për të paguar shumat e kërkuara. Përkeqësimi i kushteve ekonomike për konsumatorët mund të ketë gjithashtu efekt në parashikimet e drejtimit për flukset e ardhshme monetare dhe për vlerësimin e humbjes nga rënia në vlerë e aktiveve financiare dhe jo-financiare. Në masën që informacioni është i disponueshëm, drejtimi i Shoqërisë ka pasqyruar në mënyrë të përshtatshme përllogaritjet për flukset e pritshme monetare në vlerësimet për rënie në vlerë.

2.4 Biznesi ne vijimesi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.5 Bazat e konsolidimit

Filialet janë të gjitha subjektet (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) mbi të cilat Grupi ka fuqi për të qeverisur politikat financiare dhe operative, që në përgjithësi u atribuohen aksionereve që zoterojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme janë konsideruar kur është bërë vlerësimi nëse Grupi kontrollon një njësi tjetër ekonomike. Filialet janë konsoliduar plotësisht që nga data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Metoda e kostos është përdorur për të kontabilizuar blerjen e filialeve nga Grupi. Kostoja e blerjes është matur në vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna , instrumentave të kapitalit neto të emetuar dhe detyrimeve të pësuar ose konstatuara në datën e këmbimit, plus kostot direkte të blerjes. Aktivitetet e identifikueshme të blera dhe detyrimet e konstatuara në një kombinim biznesi njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga interesi i pakicës. Tejkalmi i kostos së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës të grupit të aktiveve neto të identifikueshme njihet si emri i mirë . Transaksionet midis shoqërive të grupit, balancat dhe fitimet e përealizuara për transaksione ndërmjet shoqërive të grupit janë eliminuar. Gjithashtu janë eliminuar humbjet e përealizuara. Politikat kontabël të filialeve janë ndryshuar kur ka qenë e nevojshme për t'u përputhur me politikat e miratuara nga Grupi.

2.6 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në Shoqëri dhe që te ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur behet pagesa. E ardhura matet me vlerë të drejtë të shprehur në mënyrë të saktë për shërbimin e kryer, neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve.

2.7 Tatim Fitimi

Tatimi është llogaritur bazuar në legjislacionin fiskal shqiptar.

Tatimi i shtyre nëse do të kishte, do të sigurohej duke përdorur metodën e detyrimeve, mbi të gjitha diferencat e perkohshme në datën e raportimit midis bazës tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerës se tyre kontabel. Tatim fitimi i shtyre aktiv dhe pasiv matet me normat tatimore që pritet të



2. POLITIKAT KONTABEL (vazhdim)

zbatohen per periudhen kur aktivi realizohet ose detyrimi shlyhet, i bazuar ne legjislacion in ne fuqi ne daten e raportimit

2.8 Aktivët Afatgjatë Materiale

Aktivët afatgjatë materiale paraqiten me kosto, duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe ndonjë renie në vlerë. Amortizimi llogaritet mbi vlerën e mbetur të aktiveve, mbi bazën e normave të mëposhtme të amortizimit:

Ndertesat	5%
Mjete Transporti	20%
Mobilje dhe orendi	20%
Makineri dhe pajisje	20%
Pajisje kompjuterike	25%

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjatë materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabel mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabel tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivët paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është me e lartë sesa vlerën e tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e tyre në përdorim.

Shpenzimet e ndodhura për të zëvendësuar një komponent të një artikulli të aktiveve afatgjatë materiale, i cili trajtohet vecmas, kapitalizohen. Shpenzimet e tjera të mëvonshme kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme të aktiveve afatgjatë materiale në fjalë. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si shpenzime kur ndodhin.

2.9 Aktivët afatgjatë jomateriale

Aktivët afatgjatë jomateriale njihen atëherë kur është e mundur që të përfitime ekonomike do të sigurohen në të ardhmen në lidhje me këto aktive dhe kostojat e tyre mund të maten në mënyrë të besueshme. Të gjitha aktivët afatgjatë jomateriale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostojat përfshijnë shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të aktivitetit. Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë shpenzimet për emrin e mirë të prodhuar vetë dhe të markave, njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin. Shpenzimet lidhur me mirëmbajtjen e programeve kompjuterike software njihen si shpenzime në momentin kur ndodhin.

Kostot e software të njohura si aktive amortizohen gjatë jetës së tyre të vlerësuar të përdorimit, që nuk i kalon katër vjet. Jetëgjatësia e aseteve është rishikuar, dhe rregullohet nëse është e përshtatshme, në çdo datë të bilancit. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabel neto, dhe janë të përfshira në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.10 Inventaret

Inventare njihen me me të voglen sesa kostos dhe vlerën neto të realizueshme. Kostot janë ato shpenzime të kryera për të sjellë çdo produkt në vendndodhjen dhe kushtet aktuale dhe përcaktohen në bazë të kostos mesatare të ponderuar.

Vlera neto e realizueshme bazohet në cmimin e vlerësuar të shitjes minus çdo kosto që pritet të ndodh në përfundim apo në nxjerrjen jashtë përdorimit.



2. POLITIKAT KONTABEL (vazhdim)

2.11 Llogarite e Arketueshme

Llogarite e arketueshme jane paraqitur me shumen e fatures origjinale minus provizionin per shuma te paarketueshme.

2.12 Mjetet Monetare

Per qellime te pasqyres se flukseve te parase, mjetet monetare perbehen nga gjendja ne arke dhe gjendja ne banke.

2.13 Zhvleresimi i Aktiveve Financiare

Nje vleresim kryhet ne cdo date raportimi per te percaktuar nese ka evidenca objektive qe nje aktiv financiar mund te jete zhvleresuar. Nese ekziston nje evidence e tille cdo humbje nga zhvleresimi njihet ne pasqyren e te ardhurave. Zhvleresimi percaktohet si me poshte:

- Per aktive te mbajtura me vleren e drejte, zhvleresimi eshte diferenca ndermjet kosos dhe vleres se drejte, minus cdo humbje te meparshme nga zhvleresimi te njohur ne pasqyren e te ardhurave gjithperfishrese.
- Per aktive te mbajtura me kosto, zhvleresimi eshte diferenca ndermjet vleres kontabel neto dhe vleres aktuale te flukseve te parase te skontuar me normen aktuale te kthimit te tregut per nje aktiv financiar te ngjashem.

2.14 Perfitimet e punonjesve

Shoqeria kryen paguan vetem kontributet ndaj sigurimeve shoqerore e shendetesore te detyrueshme, qe sigurojne perfitimet per pensione te punonjesve ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet lokale jane pergjegjese per percaktimin e kufirit minimal ligjor te vendosur per pensionet ne juridiksionin perkates sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar.

2.15 Pagesat e qerasë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rrezeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhenesi klasifikohen si qira operative. Pagesat e qirave të zakonshme njihen me metodën lineare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës së qirasë.

Stimujt e marë në një Qira të zakonshme njihen si pjesë integrale e shpenzimeve të qirasë përgjatë periudhës së qirasë.

2.16 Llogarite e pagueshme dhe te shtyrat

Detyrimet njihen per shumat te cilat duhet te paguhet ne te ardhmen per te mirat dhe sherbimet e perfituara, qofte te faturuara nga furnizuesi apo jo.

2.17 Provizionet

Provizionet njihen kur shoqeria ka nje detyrim (ligjor ose konstruktiv) te lindur si pasoje e nje ngjarje te shkuar, dhe kostot per te shlyer detyrimin jane te mundshme dhe ne gjendje per t'u matur ne menyre te besueshme.

Provizionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te mjeteve monetare me nje norme para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parasë dhe per risqet specifike te detyrimit.



2. POLITIKAT KONTABEL (vazhdim)

2.18 Huamarrjet / Huadhëniet

Huamarrjet / huadhëniet paraqiten dhe vlerësohen fillimisht me vlerën e drejtë pa përfshirë shpenzimet e transaksionit. Pas njohjes fillestare huadhëniet dhe huamarrjet paraqiten me kosto të amortizuar dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke u bazuar në interesin efektiv të çdo diference midis koston dhe vlerës së riblerjes përgjatë periudhës së huamarrjes.

Huamarrjet / huadhëniet janë klasifikuar si detyrime afat-shkurtra përveç rastit kur Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyrjes së detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

Kostot e huamarrjes njihen si shpenzim në periudhën në të cilën ndodhin.

2.19 Transaksione ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj rregjistrohen me kursin ne daten e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare ne valute te huaj perkthehen me kursin ne daten e raportimit sipas Bankes se Shqiperise. Te gjithë diferencat nga kursi i kembimit pasqyrohen ne pasqyren e te ardhurave gjitheperfshirese.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Dollari amerikan (USD)	115.23	101.86
NJ.M.B European (EUR)	140.14	140.20
Poundi Britanik (GBP)	179.48	168.39
Franga Zvicerane (CHF)	116.52	114.41

2.20 Angazhimet dhe kontigjencat

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato paraqiten ne shenime te pasqyrave financiare per sa kohe qe mundesia per nje dalje te burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike eshte e larget. Nje aktiv i kushtezuar nuk paraqitet ne pasqyrat financiare por paraqitet ne shenime per sa kohe ekziston mundesia e hyrjes se perfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve te kushtezuara njihet si provizion, nese eshte e mundshme qe ngjarjet e ardhshme te konfirmojne qe nje detyrim ka lindur ne daten e pozicionit financiar dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshme i shumes se humbjes.

2.21 Transaksionet me palet e lidhura

Palet e lidhura percaktohen kur nje pale kontrollohet nga pala tjeter, ose ka ndikim te rendesishem ne vendimet e biznesit apo vendimet financiare te pales tjeter. Per qellime te paraqitjes se pasqyrave financiare, drejtimi i shoqerise dhe manaxhimi konsiderohen si pale te lidhura.

2.22 Kapitali aksioner

Kapitali aksioner i Shoqerise njihet me vleren nominale. Aksionet e zakonshme të emetuara klasifikohen si kapital aksionar.

2.23 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.



2. POLITIKAT KONTABEL (vazhdim)

2.24 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare (vazhdim)

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit raportohen mbi baza neto.

2.25 Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

2.26 Standarde dhe interpretime të emetuara por ende te pa përvetësuara

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë bere efektive prej 1 Janarit 2014:

- Amendimi ne SNK 32, "Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare" (emetuar ne Dhjetor 2011 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Amendimi ka shtuar udhezime aplikimi per SNK 32 i cili adreson mosperputhjet e identifikuara ne aplikimin e disa prej kriterëve te kompensimit. Kjo përfshin qartësimin e paragrafit "momentalisht ka nje te drejte te detyruar me ligj per kompensim" dhe qe disa sisteme te shlyerjes bruto mund te konsiderohen si ekuivalente te shlyerjeve neto. Standardi sqaroi se nje e drejte per komensim (a) nuk duhet te kushtëzohen nga ngjarje ne te ardhmen dhe (b) duhet te jete i detyrueshëm ligjërisht ne te gjitha rrethanat ne vijim: (i) ne rrjedhën normale te biznesit, (ii) ne rast mosfunksionimi dhe (iii) ne rast falimentimi. Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqërisë.

Amendimi ne SNRF 10, SNRF 12, SNK 27 "Njesite ekonomike Investuese" (emetuar ne 31 Tetor 2012 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Standardi i amenduar nuk ka nje efekt ne pasqyrat financiare te Shoqërisë.

Amendimi ne KIRFN 21, "Taksat" (emetuar ne 20 Maj 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqërisë.

Amendimi ne SNK 36, "Dhenia e informacionit mbi shumat e rikuperueshme per aktivet jo-financiare" (emetuar ne Maj 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014; aplikimi i meparshem eshte i lejuar ne qofte se eshte aplikuar SNRF 13 per periudhen kontabel dhe periudhen krahasuese). Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqërisë.

Amendimi ne SNK 39, "Zevendesimi i Derivateve dhe vijimesia e Kontabilitetit Mbrojtes" (emetuar ne Qershor 2013 dhe efektiv me ose pas 1 Janar 2014). Standardi i amenduar nuk ka nje impakt material ne pasqyrat financiare te Shoqërisë.



2. POLITIKAT KONTABEL (vazhdim)

2.26 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende te pa pervetesuara (vazhdim)

Ne daten e aprovimit te ketyre pasqyrave financiare, standardet e meposhtme, interpretimet dhe rishikimet jane emetuar por nuk jane ende efektive:

- SNRF 9 "Instrumentat financiare: klasifikimi dhe matja" (amenduar ne Korrik 2014 dhe efektiv per periudhat me ose pas 1 Janar 2018).
- Amendime ne SNK 19 – "Skemat e perfitimeve te percaktuara: Kontributet e punonjesve" (emetuar ne Nentor 2013 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me 1 Korrik 2014).
- Permiresimet vjetore per SNRF-te 2012 (emetuar ne Dhjetor 2013 dhe efektive per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Korrik 2014, pervec kur shprehet ndryshe me poshte).
- Permiresimet vjetore per SNRF-te 2013 (emetuar ne Dhjetor 2013 dhe efektive per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Korrik 2014).
- SNRF 14, Llogarite rregullatore e shtyrjes (emetuar ne Janar 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Janar 2016).
- Kontabilizimi per blerjet e interesave ne Operacionet e Perbashketa – Amendime ne SNRF 11 (emetuar me 6 Mah 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Janar 2016).
- Qartesimi i metodave te pranueshme per Amortizimin dhe Zhvleresimin – Amendime ne SNK 16 dhe SNK 38 (emetuar me 12 Maj 2014 dhe edektiv per periudhat me ose pas 1 Janar 2016).
- SNRF 15, Te ardhurat nga Kontratat me Klientet (emetuar me 28 Maj 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 janar 2017).
- Bujqesi: Bimet Prodhuese – Amendime ne SNK 16 dhe SNK 41 (emetuar me 30 Qershor 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me 1 Janar 2016).
- Metoda e kapitalit ne pasqyrat financiare individuale – Amendimet ne SNK 27 (emetuar me 12 Gusht 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me 1 Janar 2016).
- Shitje ose Kontribut ne asete midis nje Inestitori dhe bashkepunetorit te tij ose sipermarrjes se perbashket – Amnedime ne SNRF 10 dhe SNK 28 (emetuar me 11 Shtator 2014 dhe efektiv per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Janar 2016).
- Permiresimet vjetore per SNRF-te 2014 (emetuar ne 25 Shtator 2014 dhe efektive per periudhat qe fillojne me ose pas 1 Janar 2016).
- Dhenia e informacioneve shpjeguese sipas Amendimeve te SNK 1 (emetuar ne Dhjetor 2014 dhe efektiv per periudhat me ose pas 1 Janar 2016).
- Njesite ekonomike investuese: Aplikimi i Perjashtimit te Konsolidimit amendim ne SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 (emetuar ne Dhjetor 2014 dhe efektiv per periudhat me ose pas 1 Janar 2016).

Kompania ka zgjedhur te mos i pervetesoje keto standarde, rishikime dhe interpretime para dates qe ato do te behen efektive. Kompania parashikon se pervetesimi i ketyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do te kete efekt ne pasqyrat financiare te kompanise ne periudhen e aplikimit fillestar te tyre.



3. GJYKIME, ÇMUARJE DHE SUPOZIME

Pregatitja e pasqyrave financiare te Shoqerise kerkon nga manaxhimi qe te perdore gjykimin, cmuarjet dhe supozime qe ndikojne mbi vlerat e raportuara te te ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve dhe shpalosjeve te detyrimeve te kushtezuara, ne fund te periudhes raportuese. Megjithate, pasiguria ne keto supozime dhe cmuarje mund te rezultojne ne perfundime qe kerkojne nje rregullim material te vleres se mbartur te aktivitetit ose detyrimit qe ndikohet ne periudhat e mevonshme.

Çmuarjet dhe supozimet

Supozimet kryesore te lidhura me te ardhmen dhe burime te tjera kryesore te pasigurise ne cmuarje ne daten e raportimit, qe kane nje risk te madh te shkaktohet te nje rregullimi material te vleres se mbartur te aktivitetit dhe detyrimit brenda vitit financiar te ardhshem . Shoqeria i bazon supozimet dhe cmuarjet e saj ne parametra qe ekzistojne ne daten kur jane pregatitur pasqyrat financiare. Megjithate, rrethanat dhe supozimet ekzistuese ne lidhje me zhvillime te ardhshme, mund te ndryshojne per shkak te ndryshimeve ne treg, apo rrethanave qe jane jashte kontrollit te Shoqerise. Te tilla ndryshime reflektohen ne supozime kur ndodhin.

Renia e vleres e aktiveve jo-financiare

- Nje renie vlere ekziston kur vlere e mbartur e nje aktivi apo njesie gjeneruese te parase tejkalon vleren e rikuperueshme te tij qe eshte me e larta ndermjet vlere se drejte pakesuar me kostot e shitjes dhe vlere se perdorim. Llogaritja e vlere se drejte pakesuar me kostot e shitjes bazohet ne te dhenat ekzistuese
- prej transaksioneve detyruese te shitjes ne transaksione me vlere tregu per aktive te ngjashme ose cmime tregu te vezhguara pakesuar me kostot shtese per nxjerrjen e aktivitetit jashte perdorimit.

Në mënyrë të veçantë, informacioni për pjesë specifike të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimet kritike për zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumatat e paraqitura në pasqyrat financiare, përfshihet në shënimet e mëposhtme:

Shënimi 11 – Aktivitet afatgjatë materiale;

Shënimi 15 – Llogaritë tregtare të arkëtueshme – rënia në vlerë e llogarive të arkëtueshme;

Shënimi 25 – Vlera e drejte e instrumentave financiare

Shënimi 27 – Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara



4. TE ARDHURA

Te ardhurat perfshijne vleren totale te sherbimeve te shitura gjate vitit si me poshte:

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Te ardhura nga reklamat	1,380,951,118	1,505,759,411
Te ardhura nga sherbime te ndryshme	211,618,057	217,509,777
Te ardhura nga te drejtat e transmetimi	21,681,392	24,713,964
Te ardhura nga qeraja	3,083,874	7,764,369
Të ardhura nga sms	646,320	2,008,487
Te ardhura nga shitje te tjera	1,695,000	1,490,876
Te ardhura nga shitja e materialit te arkives	190,519	260,299
	1,619,866,280	1,759,507,183

- Tabela me poshte perfaqeson rakordin e te ardhurave me deklarimet mujore te TVSH te bera ne sistemin elektronik tatimor.

	Viti 2014
Rakordini i te ardhurave me FDP-ne	
Qarkullim i tatueshem	1,768,348,786
Zbriten Autofaturimet 2014	(122,328,109)
Zbriten Paradhenie ne mbyllje te vitit ushtrimor	(139,802,295)
Shtohen Paradhenie ne celje te vitit ushtrimor	116,020,760
Diferenca konvertimi nga parapagimet ne monedhe te huaj	442,409
Shtyrje te ardhurash ne vitin 2015	(4,166,667)
Rrimarrje te ardhura nga viti 2014	1,351,396
Shuma e qarkullimit e korrektuar	1,619,866,280
Te ardhurat e vitit ushtrimor sipas PA&SH :	1,619,866,280



Handwritten signature

5. SHPENZIME TE TJERA TE VEPRIMTARISE SE SHFRYTEZIMIT

Ky ze perfaqeson shpenzime te tjera te kryera nga shoqeria ne ndihme te aktivitetit te saj
Keto shpenzime jane evidentuar konform faturave te rregullta te cilat jane paraqitur ne librat e blerjes
Brenda vleres se shpenzimeve jane perfshire edhe shpenzimet te cilat jane te panjohura per efekt fiskal

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Te drejta sherbime	128,474,262	114,486,392
Shpenzime per honorare	86,120,976	71,423,627
Koeficient kreditimi/veshje etj	69,613,671	57,941,956
Shpenzime Qeraje	51,440,298	59,245,965
Blerje te pastokushme	27,441,076	12,367,235
Sponsorizim	7,610,100	5,069,894
Blerje,energji,avull,uje	21,495,416	11,817,808
Shpenzime karburanti	15,190,523	16,035,271
Shpenzime Kancelari	2,879,811	2,494,125
Shp skenografi,instalime	3,478,238	5,858,924
• Abonime gazeta,revista	1,906,328	1,698,855
Mirëmbajtje dhe riparime	12,709,550	15,284,222
Sigurime	17,107,969	17,873,193
Sherbim roje private	7,783,944	9,526,265
Konsulence/Auditim e sherbime te tjera	11,477,513	8,438,554
Publicitet, reklama	10,756,445	17,963,048
Telefon fiks/mobile	25,801,431	32,453,568
Shpenzime transporti	4,541,864	6,455,265
Te tjera	48,960,776	32,667,001
	554,790,191	499,101,168

6. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit perfshijne pagat bruto dhe shpenzimet per sigurime te punedhenesit per zyren e Tiranes .

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Shpenzime per paga	643,508,393	622,398,503
Shpenzime per sigurime shoqerore e shendetsores	79,046,279	73,474,433
	722,554,672	695,872,936



7. SHPENZIME ZHVLERESIMI DHE AMORTIZIMI

Shpenzimet e amortizimit per vitin 2014 paraqiten ne vleren 124,794,013 leke.

Ne zerin Kuota pjese e shpenzimeve per t'u shperndare, jane paraqitur kuota pjese e shpenzimeve te skenografive qe i takojne vitit ushtrimor 2014.

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Shpenzime amortizimi	124,794,013	108,091,166
Kuota pjese e shpenzimeve per t'u shperndare	62,008,526	85,321,493
Shpenzime zhvleresimi (borxh i keq)	9,398,613	50,549,623
	196,201,152	243,962,282

8. SHPENZIME TE TJERA

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Taksa te ndryshme	8,406,906	8,589,097
Gjoha	493,524	4,610,029
Komisione bankare etj	2,011,143	4,342,171
Vlera kontabel neto e AAM J/P dhe te tjera shpenzime	38,488,722	96,987,458
	49,400,295	114,528,756

9. SHPENZIME FINANCIARE NETO

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Shpenzime per interesa	81,303,461	77,454,408
Te ardhura nga interesat	(2,819)	(2,961)
Humbje nga kembimet valutore	5,571,252	21,990,935
Te ardhura nga kembimet valutore	(4,970,052)	(17,220,324)
Te ardhura nga rrimarje provizioni	(30,000)	(55,385)
Te ardhura nga falja e gjobave	(800,040)	-
Te tjera	681,883	(16,965,931)
	81,753,683	65,200,742



Handwritten signature

TOP CHANNEL sha
Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

10. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

	Dhjetor 31, 2014	Dhjetor 31, 2013
<i>Fitimi para tatimit</i>	15,166,287	140,841,299
<i>Humbje mbartur nga viti kaluar</i>	-	(37,869,462)
Shpenzime te panjohura	64,423,396	83,617,411
<i>Fitimi para tatimit</i>	79,589,683	186,589,248
<i>Tatim fitimi norma 15% (2013: 10%)</i>	(11,938,452)	(18,658,925)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	3,227,835	122,182,374

Teprica kreditore e Tatim Fitimit deri me 31 dhjetor 2014 ne LEK :

Celje sipas sistemit tatimor 01/01/2014	1,241,533
Parapagim gjate vitit 2014	13,997,098
Total teprice Tatim Fitimi	15,238,631
Shpenzime tatim fitimi viti 2014	(11,938,452)
Teprica kreditore e tatim-fitimit me 31 dhjetor 2014	3,300,179



Handwritten signature

TOP CHANNEL sha

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

11. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE

	Toka	Ndërtesa	Instalime te perqijshme	Mobilje dhe orendi	Pasqje zyrtre dhe Informatike	Mjete transporti	Të tjera	AAM ne proces	AAM	Totali
Kosto										
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	221,369,378	126,969,154	1,111,571,163	43,533,625	95,664,615	137,311,194	21,573,630	862,257,582	48,782	2,620,299,123
Shesa	-	-	27,094,107	7,499,517	5,626,865	5,469,094	108,476	352,805,670	420,468	399,024,197
Nxierje/jashë përdorimit	-	122,630,711	202,554	1,269,965	28,948,839	10,217,860	-	-	-	163,269,929
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	221,369,378	4,338,443	1,138,462,716	49,763,177	72,342,641	132,562,428	21,682,106	1,215,063,252	469,250	2,856,053,391
Shesa	-	-	26,264,915	121,696,464	6,800,771	718,324	-	193,359,972	-	348,840,446
Shesa KS&MK	-	-	-	48,229	40,380	-	-	-	-	88,609
Paketime	-	-	4,584,907	6,533,759	5,667,714	31,100	-	(96,745,654)	-	16,817,480
Riklasifikim ne AAM	-	-	96,745,654	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	221,369,378	4,338,443	1,256,888,378	164,974,111	73,516,078	133,249,652	21,682,106	1,311,677,570	469,250	3,188,164,966
Amortizimi i akumuluar										
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	-	49,188,890	714,805,779	27,539,121	57,587,672	87,964,177	16,146,246	-	8,537	953,240,422
Amortizimi i vitit	-	1,672,079	81,820,012	3,471,523	9,819,512	10,217,138	1,090,902	-	7,317	108,098,483
Nxierje/jashë përdorimit	-	49,242,565	144,400	637,747	14,863,004	6,372,675	-	-	-	71,260,391
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	-	1,618,404	796,481,391	30,372,897	52,544,180	91,808,640	17,237,148	-	15,854	990,078,514
Amortizimi i vitit	-	136,002	89,689,953	19,118,332	5,931,486	8,202,505	888,985	-	70,388	124,037,651
Amortizimi i vitit KS&MK	-	-	-	345,071	411,282	-	-	-	-	756,353
Kthim Amortizimi	-	-	3,622,120	5,251,207	4,957,917	24,961	-	-	-	13,856,205
Nxierje/jashë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	-	1,754,406	882,549,224	44,585,094	53,929,031	99,986,184	18,126,133	-	86,242	1,101,016,313
Vlera neto kontabel										
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	221,369,378	77,780,264	396,765,384	15,994,504	38,076,943	49,347,017	5,427,384	862,257,582	40,245	1,667,058,700
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	221,369,378	2,720,039	341,981,325	19,390,280	19,798,461	40,753,788	4,444,958	1,215,063,252	453,396	1,865,974,884
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	221,369,378	2,584,037	374,339,154	120,389,017	19,587,047	33,263,468	3,555,973	1,311,677,570	383,008	2,087,148,653



11. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE (VAZHDIM)

GARANCI BANKARE (KOLATERAL)

Kompania ka vendosur garanci bankare per transaksionet me palet e treta si me poshte :

- a) Toka dhe ndertesa e hipotekuar eshte lene si kolateral per kredine me Raiffeisen Bank (kredia 7.000.000 €uro) dhe Union Bank (kredia 400.000 €uro dhe OverDraft 300.000 €uro)
- b) Makineri dhe pajisje per OverDraft e Raiffeisen Bank, Societe Generale, Union Bank dhe per kredine me Societe Generale Albania Bank.

12. HUA TE DHENA PALEVE TE TRETA

Ne kete ze jane paraqitur hua te dhena per te tretet:

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Hua e dhene paleve te treta	4,557,319	4,557,319
	4,557,319	4,557,319

Kjo hua eshte dhene per nje vlere ne Lek 500,000 dhe Euro 28,700 me nje afat shlyerje 4 vjecar dhe eshte pa interes.

13. INVENTARI

Ne inventar eshte paraqitur gjendja e mallrave me 31 Dhjetor 2014

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Mallra	675,438	4,700,556
	675,438	4,700,556

14. LLOGARI TE ARKETUESHME TREGTARE

Ne kete ze jane paraqitur klientet e pa arketuar me 31 Dhjetor 2014

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Kliente	592,307,250	644,900,300
Zhvleresim i llogarive te arketueshme	(60,396,967)	(62,670,733)
	531,910,283	582,229,567

Levizjet ne zhvleresimin e te drejtave per arketim:

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Gjendja me 1 Janar	62,670,733	14,444,786
Rimarrje ne vitin 2014	(30,000)	(2,323,676)
Fshirje klienti	(11,642,379)	-
Zhvleresimi per vitin 2014	9,398,613	50,549,623
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	60,396,967	62,670,733

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të kredisë dhe pozicionit valutor si dhe humbjet nga zhvlerësimi lidhur me kërkesat për arketim janë të paraqitura në shënimin 28.



Handwritten signature

15. LLOGARITE TE ARKETUESHME TE TJERA

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Tatim Fitimi	3,300,179	878,429
Paradhenie per personelin	-	1,828,599
Garanci	7,299,689	6,584,128
Te tjera	3,689,285	9,166,825
	14,289,153	18,457,981

16. PARAPAGIME PER FURNIZIME

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Parapagime per furnitore	18,456,547	8,335,716
	18,456,547	8,335,716

17. SHPENZIME TE PERIUDHAVE TE ARDHME

Ne kete ze jane paraqitur shpenzime te cilat i perkasin periudhave te ardhme per skenografite, te drejta dhe te tjera shpenzime te periudhave te ardhme.

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Shpenzime te periudhave te ardhme	101,401,562	103,847,897
	101,401,562	103,847,897

18. MJETE MONETARE

Mjetet monetare ne banke dhe ne arke me 31.12.2014 paraqiten si me poshte:

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Mjete monetare ne banke	12,149,217	11,637,834
Llogari rrjedhese	12,149,217	11,637,834
Depozita me afat	-	-
Mjete monetare ne arke	1,533,655	3,964,070
	13,682,872	15,601,904

Shoqeria mban llogarite e saj bankare prane disa bankave si: Union Bank, Raiffeisen Bank, Intesa San Paolo etj.



[Handwritten signature]

19. KAPITALI AKSIONER

Kapitali i nenshkruar eshte i ndare ne 5,254 aksione me vlere nominale 100,000 leke secila

Struktura e aksionereve eshte si vijon:

	2014		2013	
	Ne Leke	Ne %	Ne Leke	Ne %
Vjollca Hoxha	42,032,000	8%	42,032,000	8%
Lorela Hoxha	42,032,000	8%	42,032,000	8%
Sara Hoxha	42,032,000	8%	42,032,000	8%
Redia Hoxha	42,032,000	8%	42,032,000	8%
Itan Hoxha	42,032,000	8%	42,032,000	8%
Albert Sino	210,160,000	40%	210,160,000	40%
Aurel Baci	105,080,000	20%	105,080,000	20%
Ne fund te vitit ushtrimor	525,400,000	100%	525,400,000	100%

20. HUA AFATGJATA

Pjesa Afatgjate e Hua-se Afatgjata perbehet nga shuma e huase ne Raiffeisen Bank, Societe Generale Albania Bank dhe Union Bank:

	2014	2013
	ne Lek	ne Lek
Raiffeisen Bank sha	708,310,053	796,104,757
Union Bank	50,824,110	-
Societe Generale sha	11,612,802	33,760,297
Top Gold	3,469,266	-
	774,216,231	829,865,054

21. HUA AFATSHKURTRA

	2014	2013
	ne Lek	ne Lek
OVERDRAFT		
Union Bank sha - Leke	9,727,122	9,155,578
Union Bank sha - Leke	28,936,100	-
Raiffeisen Bank - Leke	12,065,056	10,080,565
Raiffeisen Bank - Euro	13,909,360	10,379,020
Raiffeisen Bank - Leke	45,315,136	44,627,762
Societë Generale - Leke	41,041,132	39,689,493
Societë Generale -Leke	35,346,877	34,760,381
Te tjera hua afatshkurtra	17,349,424	2,446,932
	203,690,207	151,139,730



Handwritten signature

21. HUA AFATSHKURTRA (vazhdim)

Pjesa Afatshkurter e Huase Afatgjate	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Raiffeisen Bank sha	115,920,464	164,265,243
Societè Generale sha	22,133,047	20,759,885
Union Bank	5,231,890	-
Top Gold	1,936,334	-
Interesa te perlogaritura	246,391	396,993
Total	145,468,126	185,422,121
TOTAL AFATSHKURTER	349,158,333	336,561,851

Shoqeria ka nje hua afatgjate me Raiffeisen Bank me nje kufi EUR 7 milion me nje norme interesi te ndryshueshem prej Euribor 1 vjecar + 5% ne Euribor 1 vjecar + 5% +1%. Ne 31 Dhjetor 2014 shuma e mbetur e huase ishte EUR 5.881 milion (31 Dhjetor 2013: EUR 6.850 milion).

- Shoqeria, gjithashtu ka nje hua afatgjate me Societe Generale Albania Bank nje kufi EUR 1,5 milion nje norme interesi te ndryshueshem prej Libor Eur 12m + 4% ne min 6,5%. Ne 31 Dhjetor 2014 shuma e mbetur e huase ishte EUR 240,800 (31 Dhjetor 2013: EUR 388,374).

Gjate vitit 2014, shoqëria ka nënshkruar nje kontrata huaje për Eur 400,000 me Union Bank, me 75 këste mujore, duke filluar që nga data e pagesës së parë të interesit mbas 9 muaj të disbursimit të shumës. Huaja ka nje interes vjetor norme baze interesi + 3.5% , por jo me i ulet se 7%. Ne 31 Dhjetor 2014 shuma e perdorur e huase ishte Eur 400,000.

Ekspozimi i shoqerise ndaj risqeve te tregut dhe analiza e ndjeshmerise ndaj tyre jane analizuar ne shenimin 28.

22. LLOGARI TE PAGUESHME TREGTARE

Ky ze perfaqeson detyrimet e palikujduara nga shoqeria ndaj furnitoreve ne daten e mbylljes se pasqyrave financiare

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Llogari te pagueshme tregtare	580,867,700	400,078,892
	580,867,700	400,078,892

Ekspozimi i shoqerise ndaj risqeve te tregut dhe analiza e ndjeshmerise ndaj tyre jane analizuar ne shenimin 28.

23. PARAPAGIME TE ARKETUESHME

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Parapagime te arketueshme	139,802,295	116,020,760
	139,802,295	116,020,760



Handwritten signature

24. TE ARDHURA TE SHTYRA

Ky ze perfaqeson te ardhurat e shtyra per vitin 2015 te faturuara ne dhjetor 2014.

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Te ardhura te shtyra	4,166,667	2,199,045
	4,166,667	2,199,045

25. LLOGARI TE PAGUESHME TE TJERA

Llogarite e pagueshme te tjera perfaqesojne Detyrimet Tatimore per : Sigurime Shoqerore dhe Shendetesore, Tatimin mbi te ardhurat personale, TVSH-ne e muajit Dhjetor 2014 ,si edhe detyrime te tjera ndaj te treteve.

	2014 ne Lek	2013 ne Lek
Detyrime per sigurime shoqerore e shendetesore	12,097,896	11,073,719
Detyrime per tatimin mbi te ardhurat personale	7,020,320	6,607,536
Paga per tu paguar	4,673,179	4,496,024
Tatim ne burim	-	419,230
TVSH per t'u paguar	3,579,878	3,240,147
Te tjera detyrime Kosove dhe Maqedoni	5,255	30,675
Kreditore te tjere	8,141,543	7,948,195
	35,518,071	33,815,525

26. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

Keto perfaqesojne transaksionet me palet e lidhura, per shembull aksioneret e shoqerise, dhe njesite e kontrolluara, te kontrolluara bashkarisht ose kane nje ndikim te konsiderueshem nga palet e tilla.

Transaksionet me palet e lidhura te perfshira ne pasqyrat financiare jane si me poshte:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Llogari te arketueshme - Palet e lidhura

	2014 Leke	2013 Leke
Digitalb sha	716,060	44,867,148
VGA shpk	1,344,600	-
Fondacioni "Dritan Hoxha"	1,400,000	3,856,784
Shqip shpk	3,514,742	3,938,892
Saras shpk	961,209	586,330
Valtelina shpk	-	320,000
Plus Communicaton	50,851,859	29,979,189
Alsi & Co shpk	2,285,000	2,005,000
Vini&Food	81,000	81,000
	61,154,470	85,634,343



Handwritten signature

26. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA (vazhdim)

Llogari te pagueshme - Palet e lidhura

	2014	2013
	Leke	Leke
VGA shpk	3,061,776	485,776
Plus Communication	-	2,903
Hua afatshkurter - administrator	17,284,500	-
Hua afatgjate - aksioner	22,438,395	22,438,395
	42,784,671	22,927,074

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBYES DHE E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

Shitje ndaj Paleve e lidhura

	2014	2013
	Leke	Leke
Digitalb sha	316,514,601	259,279,140
VGA shpk	3,244,184	1,589,994
Shqip shpk	2,289,688	2,600,448
Fond "Dritan Hoxha"	1,726,667	6,399,346
Valtelina shpk	960,000	960,000
Alsi&Co	280,000	540,000
Saras	375,000	305,000
Plus Communication	22,243,093	25,818,230
	347,633,233	297,492,158

Blerje ndaj Paleve e lidhura

	2014	2013
	Leke	Leke
Digitalb sha	3,481,780	-
VGA shpk	8,605,000	8,100,000
	12,086,780	8,100,000

Paga Drejtimi i Shoqerise

	2014	2013
	Leke	Leke
Paga Drejtimi i Shoqerise	8,118,188	8,106,660
	8,118,188	8,106,660



27. ANGAZHIMET PER SHPENZIMET

Angazhimet per qera operative paraqiten si me poshte:

	2014 Leke	2013 Leke
Brenda nje viti	6,192,006	6,918,470
Me shume se nje vit me pak se pese vjet	-	-
	6,192,006	6,918,470

28. MANAXHIMI I RISKUT

Detyrimet financiare kryesore te Shoqerise perbehen nga llogarite e pagueshme dhe te tjera detyrime. Qellimi kryesor i ketyre detyrimeve financiare eshte te financojne operacionet e Shoqerise dhe te sigurojne garanci per mbeshtetjen e operacioneve Shoqeria ka hua dhe llogari te arketueshme, mjete monetare qe sigurohen drejteperdrejte nga operacionet e saj Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj riskut te tregut, riskut te kreditit dhe riskut te likuiditetit.

Manaxhimi i Shoqerise mbikqyr manaxhimin e ketyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut eshte risku qe vlera e drejte e flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne cmimet e tregut Cmimet e tregut perfshijne kater tipe risqesh: risku i normes se interesit, risku i kursit te kembimit, risku i cmimit te mallrave dhe risqe te tjera te cmimeve, te tilla si risku i cmimit te kapitalit Instrumentat financiar te prekur nga risku i tregut perfshijne huate dhe kredite.

Risku i normave te interesit

Risku i normes se interesit perbehet nga risku qe vlera e flukseve monetare te ardhshme te nje instrumenti financiar do te varioje per shkak te ndryshimeve ne normat e interesit ne treg dhe riskut qe maturitetet e aktiveve qe mbartin interes te ndryshojne nga maturitetet e detyrimeve qe mbartin interes te perdorura per te financuar ato aktive Zgjatja kohore pergjate te ciles norma e interesit e nje instrumenti financiar eshte fikse, percakton se ne cfare mase eshte e ekspozuar ndaj riskut te normes se interesit Aktivet dhe detyrimet e Shoqerise mbartin norma interesi te tregut.



28. MANAXHIMI I RISKUT (vazhdim)

Risku i normave te interesit (vazhdim)

	31 Dhjetor	
	2014	2013
Aktive Financiare		
<i>Qe nuk mbartin interes</i>		
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	546,199,005	600,687,549
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	1,533,655	3,964,070
	547,732,660	604,651,619
<i>Me norma interesi fikse</i>		
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	12,149,217	11,637,834
	12,149,217	11,637,834
Detyrime Financiare		
<i>Që nuk mbartin interes</i>		
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme	616,385,771	433,894,417
Huatë	19,698,838	19,698,838
	636,084,609	453,593,255
<i>Me norma interesi të ndryshueshme</i>		
Huatë që mbartin interes	1,123,374,564	1,166,426,905
	1,123,374,564	1,166,426,905



28. MANAXHIMI I RISKUT (vazhdim)

Risku i kreditit

Risku i kreditit eshte risku qe nje pale tjetër nuk do te jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj qe rrjedhin nga nje instrument financiar ose marreveshje klienti, duke cuar keshtu ne nje humbje financiare. Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj riskut te kreditit per shkak te aktiviteve operacionale te saj (pikeseperi prej llogarive te arketueshme) dhe prej aktiviteve te saj financuese, qe perfshijne depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet ne monedha te huaja dhe instrumenta te tjere financiare.

	31 Dhjetor	
	2014	2013
Llogari te arketueshme	531,152,781	496,595,224
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	61,154,470	85,634,343
Llogari te tjera te arketueshme	14,289,153	18,457,981
Mjete Monetare	13,682,872	15,601,904
	620,279,276	616,289,452

	31 Dhjetor	
	2014	2013
Llogari te arketueshme me zhvleresim specifik	592,307,251	644,900,300
Llogari te arketueshme me zhvleresim kolektiv	-	-
Shuma totale	592,307,251	644,900,300
Zhvleresim specifik	60,396,967	62,670,733
Zhvleresim kolektiv	-	-
Shuma e zhvleresimit	60,396,967	62,670,733
Gjendja ne fund te vitit	531,910,283	582,229,567

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Gjendja ne fillim te vitit	62,670,733	14,444,786
Zhvleresim gjate vitit	9,398,613	50,549,623
Rrimarje gjate vitit	(11,672,379)	(2,323,676)
Gjendja ne fund te vitit	60,396,967	62,670,733



28. MANAXHIMI I RISKUT (vazhdim)

Analiza e vjetersise se klienteve :

	2014 Leke	2013 Leke
Nga 1-6 muaj	241,278,649	301,437,806
Nga 6-12 muaj	81,045,406	177,126,988
Mbi 12 muaj	269,983,196	166,335,506
	592,307,251	644,900,300

	Jo te vonuara dhe te pa zhvleresuara	Te vonuara por te pa zhvleresuara	Te zhvleresuara	Totali
2014				
Kliente dhe te tjera kerkesa per arketim	322,323,769	209,587,054	60,396,967	592,307,790
Provizione	-	-	(60,396,967)	(60,396,967)
Totali-neto	322,323,769	209,587,054	-	531,910,823

	Jo te vonuara dhe te pa zhvleresuara	Te vonuara por te pa zhvleresuara	Te zhvleresuara	Totali
2013				
Kliente dhe te tjera kerkesa per arketim	478,564,794	103,664,773	62,670,733	644,900,300
Provizione	-	-	(62,670,733)	(62,670,733)
Totali-neto	478,564,794	103,664,773	-	582,229,567

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit eshte risku qe Shoqeria mund te mos jete ne gjendje te paguaje detyrimet e saj te lidhura me detyrimet financiare ne momentin e pageses Risku i likuiditetit eshte risk i qenesishem ne biznesin e Shoqerise pasi disa aktive specifike te blera apo detyrime te shitura mund te kene karakteristika likuiditeti qe jane specifike. Nese Shoqeria do ti duhet te kete shuma te medha ne nje afat te shkurter kohor qe tejkalon kerketat normale per mjete monetare mundet qe te ndeshet me veshtiresi per te siguruar cmime joshese Shoqeria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar ne menyre te vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar te perputhe profilet e maturitetit te aktiveve dhe detyrimeve.



Handwritten signature

TOP CHANNEL sha

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

28. MANAXHIMI I RISKUT (vazhdim)

Risku i Likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2014						
	Deri ne 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total	
Llogari tregetare te arketueshme dhe te tjera	546,199,436	-	-	-	546,199,436	
Mjete monetare ne arke dhe banke	13,682,872	-	-	-	13,682,872	
	559,882,308	-	-	-	559,882,308	
Llogari tregetare te pagueshme dhe te tjera	(616,385,772)	-	-	-	(616,385,772)	
Hua	(179,886,134)	(151,987,657)	(805,220,301)	(5,979,310)	(1,143,073,402)	
	(796,271,906)	(151,987,657)	(805,220,301)	(5,979,310)	(1,759,459,174)	
Risku i monedhes me 31 Dhjetor 2014	(236,389,598)	(151,987,657)	(805,220,301)	(5,979,310)	(1,199,576,866)	
31 Dhjetor 2013						
	Deri ne 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total	
Llogari tregetare te arketueshme dhe te tjera	600,682,401	-	-	-	600,682,400	
Mjete monetare ne arke dhe banke	15,601,904	-	-	-	15,601,904	
	616,284,305	-	-	-	616,284,304	
Llogari tregetare te pagueshme dhe te tjera	(433,894,418)	-	-	-	(433,894,418)	
Hua	(165,449,573)	(171,112,279)	(849,563,892)	-	(1,186,125,744)	
	(599,343,991)	(171,112,279)	(849,563,892)	-	(1,620,020,162)	
Risku i monedhes me 31 Dhjetor 2013	16,940,314	(171,112,279)	(849,563,892)	-	(1,003,735,857)	



TOP CHANNEL sha

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

28. MANAXHIMI I RISKUT (vazhdim)

Risku i valutes

Shoqeria nderrmerr transaksione ne monedhe te huaj si pasoje e ekspozimit ndaj luhatjeve te kurseve te kembimit Ekspozimi ndaj kurseve te kembimit manaxhohet duke percaktuar ne politike midis te arketueshmeve dhe te pagueshmeve Vlerat kontabel te aktiveve dhe detyrimeve monetare te shoqerise sipas monedhave per vitin qe u mbyll me 31 Dhjetor 2014 jane paraqitur ne tabelen e meposhtme:

31 Dhjetor 2014						
	EUR	USD	CHF	GBP	LEK	Total
Llogari tregtare te arketueshme dhe te tjera	74,747,080	5,472,072	92,652	-	465,887,631	546,199,435
Mjete monetare ne arke dhe banke	5,372,655	270,383	77,085	15,231	7,947,519	13,682,873
	80,119,735	5,742,455	169,737	15,231	473,835,150	559,882,308
Llogari tregtare te pagueshme dhe te tjera	(188,634,123)	(3,484,391)	(174,780)	(290,122)	(423,802,356)	(616,385,772)
Hua	(984,973,072)	(17,344,564)			(140,755,766)	(1,143,073,402)
	(1,173,607,195)	(20,828,955)	(174,780)	(290,122)	(564,558,122)	(1,759,459,174)
Rrisku i kursit te kembimit me 31 Dhjetor 2014	(1,093,487,460)	(15,086,500)	(5,043)	(274,891)	(90,722,972)	(1,199,576,866)

31 Dhjetor 2013						
	EUR	USD	CHF	GBP	LEK	Total
Llogari tregtare te arketueshme dhe te tjera	109,104,197	4,739,291	156,982	-	486,681,930	600,682,401
Mjete monetare ne arke dhe banke	6,884,024	1,003,312	184,078	17,523	7,512,967	15,601,904
	115,988,221	5,742,603	341,060	17,523	494,194,896	616,284,305
Llogari tregtare te pagueshme dhe te tjera	(129,049,641)	(5,703,085)	-	(141,276)	(299,000,416)	(433,894,418)
Hua	(1,045,365,034)				(140,760,710)	(1,186,125,744)
	(1,174,414,675)	(5,703,085)	-	(141,276)	(439,761,126)	(1,620,020,162)
Rrisku i kursit te kembimit me 31 Dhjetor 2013	(1,058,426,454)	39,518	341,060	(123,753)	54,433,770	(1,003,735,857)



Foru

28. MANAXHIMI I RISKUT (vazhdim)

Risku i valutes (vazhdim)

Analiza e ndjeshmerise

Nje forcim prej 10% i Lekut ndaj EURO, USD, CHF dhe GBP ne 31 Dhjetor 2014 do te rriste/(ulte) kapitalet e veta dhe fitime ose humbjet me vlerat e treguara me poshte. Kjo analize presupozon qe te gjithë indikatorët e tjere, ne vecanti normat e interesit, te jete te pandryshuara. E njejta analize eshte bere edhe per vitin 2013.

	Kapitalet e veta	Fitime ose (humbje)
2014		
EUR	(109,348,746)	(109,348,746)
USD	(1,508,650)	(1,508,650)
CHF	(504)	(504)
GBP	(27,489)	(27,489)

	Kapitalet e veta	Fitime ose (humbje)
2013		
EUR	(105,842,645)	(105,842,645)
USD	3,952	3,952
CHF	34,106	34,106
GBP	(12,375)	(12,375)

29. VLERE E DREJTE E INSTRUMENTEVE FINANCIARE

Instrumentat financiare perfshijne aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë perbehen nga gjendja e llogarive ne banke dhe te arketueshmet Detyrimet financiare perbehen kryesisht nga llogarite e pagueshme.

Vlera e drejte e aktiveve dhe detyrimeve financiare perfshihet ne shumen ne te cilen instrumenti mund te shkembet ne nje transaksion mes paleve te gatshme, dhe jo te detyrueshme ne nje proces likuidimi ose shitje Vlerat e drejta te te gjitha aktiveve financiare te shoqerise perafrojne vlerat e tyre kontabel kryesisht per shkak te maturimit afatshkurter te ketyre instrumentave.



30. BURIMET KRYESORE NE VLERESIMIN E PASIGURISE

Zhvleresimi i llogarive te arketueshme

Nje vleresim i shumes se mbledhshme te llogarive te arketueshme tregetare kryhet kur arketimi i shumes se plote nuk eshte me e mundur Per shumat individuale te rendesishme, ky vleresim eshte kryer ne baza individuale.

31. ANGAZHIME DHE DETYRIME TE KUSHTEZUARA

Ceshtje gjyqesore

Me 31 Dhjetor 2014 Shoqeria nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqerise nuk jane audituar nga organet tatimore per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 Si rrjedhoje detyrimet tatimore nuk mund te konsiderohen perfundimtare Detyrime te mundshme qe mund te rezultojne nga nje auditim i organeve tatimore nuk mund te maten ne menyre te besueshme.

32. NGJARJET PAS DATES SE RAPORTIMIT

Me 31 Dhjetor 2014 ne daten e pasqyrave financiare dhe deri ne daten e aprovimit te tyre nuk ka ngjarje rregulluese te reflektuara ne pasqyrat financiare ose ngjarje qe jane materialisht te rendesishme per te paraqitur ne keto pasqyra.


Enkelejd Joti
Administrator




Mazars shpk
Hartues



Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirane, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al